



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

Njësia e Prokurimit

Gjilan, me datë: 28.07.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjilanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1.1 pika (a) të lidhur me nenin 62.1 pika (d) të Rregullorës Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, duke vendosur sipas Kërkesës për Rishqyrtim të datës 28.7.2023 të parashtruar nga Operatori Ekonomik “LINDI MARKINGS” Sh.p.k. për aktivitetin e prokurimit me titull: “*Sinjalizimi Horizontal, Vertikal dhe pajisjeve rrugore në komunën e Gjilanit*” me Nr. të Prok: 651-22-10313-2-1-1, mori këtë:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** e pabazuar Kërkesa për rishqyrtim e Operatori Ekonomik LINDI MARKINGS Sh.p.k me seli në Vitomiricë të Pejës e parashtruar me datë 25.07.2023 kundër Njoftimit për Vendimin të AK-së, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “*Sinjalizimi Horizontal, Vertikal dhe pajisjeve rrugore në komunën e Gjilanit*” me Nr. të Prok: 651-22-10313-2-1-1, inicuar nga AK Komuna e Gjilanit.
- II. **VËRTETOHET** Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues i dt. 21.07.2023 për aktivitetin e prokurimit “*Sinjalizimi Horizontal, Vertikal dhe pajisjeve rrugore në komunën e Gjilanit*” me Nr. të Prok: 651-22-10313-2-1-1, dhe AK – Komuna e Gjilanit vendsosë të vazhdojë më tutje me procedurën e prokurimit të përcaktuar si në pikën një dhe dy të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik LINDI MARKINGS” SH.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Operatori ekonomik “LINDI MARKINGS” Sh.p.k si palë e pakënaqur me datë 25.07.2023 ka parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim në AK- Komunën e Gjilanit kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK-së të dt. 21.07.2023 duke e atakuar Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar, përkritazi me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sinjalizimi Horizontal, Vertikal dhe pajisjeve rrurore në komunën e Gjilanit” me Nr. të Prok: 651-22-10313-2-1-1, me pretendimet kryesore që kanë të bëjnë kundër eliminimit të ofertës të OE ankues duke kërkuar aprovimin e bazuar të kërkesës dhe rishqyrtimin e vendimit.

Autoriteti Kontraktues, Komuna e Gjilanit përmes Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, konform nenit 108/a paragrafi 6 të LPP-së ka shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të evidentuara në Kërkesën për Rishqyrtim të OE ankues “LINDI MARKINGS” Sh.p.k.

Me rastin e vlerësimit preliminar të Kërkesës për Rishqyrtim të parashtruesit, Autoriteti Kontraktues ka gjetur se kërkesa në rastin konkret është parashtruar brenda afatit ligjor nga personi i autorizuar sipas paragrafit 3.2 të nenit 108/A të LPP-së dhe nenit 60.2 – b) të Rregullorës për Prokurim Publik Nr.001./2022. Nga ana tjetër, AK ka gjetur se parashtruesi i kërkesës nuk mund ta ketë statusin e palës me interes në kuptim të nenit 4 paragrafi 1.26 të LPP-së dhe Informatës së publikuar nga OSHP me dt.02.02.2023, sepse edhe sikur hipotetikiisht të kthehej lënda në rivlerësim nuk mund të dëshmojë interes material nga rezultati i këtij aktiviteti për arsye nuk ka atakuar dhe paraqitur argumente për OE tjerë të radhitur para tij se nuk janë të përgjegjshëm të cilët edhe janë më të lirë për nga çmimi.

Megjithatë, duke u mbështetur nga parimet e vlerësimit objektiv, transparent dhe të barabartë në mënyrë që të eliminojmë çdo mundësi të rrethanave që mund të rezultojë në diskriminim karrshi OE ankues, AK ka bërë shqyrtimin meritore (*in meritum*) të të gjitha pretendimeve të palës ankimore. Në këtë mënyrë, pas analizimit dhe shqyrtimit meritore të pohimeve të OE ankues të parashtruara në kërkesën për rishqyrtim në relacion me administrimin e të gjitha fakteve dhe provave materiale të kësaj lënde, AK konsideron se:

- pretendimet e parashtruesit janë të pabazuara dhe pa ndikim për vendosje ndryshe.

- Konstatimet e AK-së bazuar në faktet dhe rrethanat e rastit –

Pretendimi i parë: *Sipas përshkrimit të deklaratës mbi faktet dhe argumentet e paraqitura, përveq tjerash keni pretenduar se, arsyetimi i eliminimit kinse për çmime jo-normalisht të ulëta qon në shkelje të parimeve dhe dispozitave të ligjit të prokurimit me arsyetimin se përmes përgjigjes ndaj kërkesës për sqarim të tenderit e keni argumentuar në mënyrë të hollësishme çdo çmim dhe çdo pozicion e që sipas vlerësimit të juaj AK si ka marrë parasys. Pastaj pretendimin e keni vazhduar me arsyetimin se aplikimi i poentimit dhe çmimeve për njësi i pamundëson ligjërisht AK-së t'i referohet çmimeve dhe të bëjë krahasim të ofertave sepse OSHP përmes dhjetëra vendimeve ka vendosur ndryshe, dhe rrjeshimisht se kemi shkelur nenin 61 të LPP-së, përkatësisht nenin 27.17 të Rregullorë nr. 001/2022 që përcakton se “nuk lejohet krahasimi i çmimeve të ofertave të ndryshme me njëra tjetrën dhe të konvertohen vlerat e llogaritur në pikë, ...”*

Përgjigja e AK në pretendimin e parë:

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjilanit, sipas vlerësimit të pavarur të tij konstaton se, pretendimi i OE ankues në tërësi është i pabazuar në asnjë fakt apo provë relevante dhe bazë ligjore në relacion me pretendimet e pohuara se është kundërligjor vlerësimi i AK-së, respektivisht akti i aatakuar për eliminimin e tij. Rrjedhimisht, nuk e argumenton me asnjë provë faktin/pohimin bazë se oferta e tij është e përgjegjshme për aktivitetin në fjalë që ka ushtruar këtë kërkesë.

Sa i përket pretendimit se, oferta e juaj në vlerësimin fillestar është kualifikuar e suksesshme dhe arsyetimit se pas ankesës së juaj e njejtë është aprovuar e bazuar, ju sqarojmë se nga ana e juaj nuk është paraqitur në mënyrë të plotë gjendja faktike sepse lënda është kthyer në rivlerësim nga fillimi për shkak se ju dhe pesë OE tjerë kanë parashtruar kërkesa për rishqyrtim kundër Njoftim Vendimit të AK-së të dt. 07.04.2023 e të cilat janë aprovuar pjesërisht sipas vendimit të dt. 19.04.2023.

Lidhur me pretendimet e paraqitura që kanë të bëjë me çmim jo-normalisht të ulët, ju sqarojmë se nga ana e juaj nuk është paraqitur asnjë provë e vetme relevante që i argumenton pohimet e juaja se oferta e juaj është e përgjegjshme, mirëpo pretendimi i juaj është mbështetur në tërësi në supozime dhe paragjykitime si përpjekje për të ndryshuar rezultatin e procesit për t'i krijuar vetes favore, rrjedhimisht për të fituar një të drejtë në kundërshtim me bazën ligjore dhe nënligjore të prokurimit në fuqi.

Gjatë procedurës së rivlerësimit të tenderëve, AK ka evidentuar se në shumicën e zërave financiar të paramasës dhe paralogarisë së ofertës së juaj janë paraqitur çmime jo-normalisht të ulta në krahasim me çmimet reale të tregut sipas analizës së hulumtimit të tregut, informatave të siguruara para inicimit të aktivitetit të prokurimit për koston e specifikimeve relevante teknike të mallrave, shërbimeve ose punëve për lëndën e prokurimit.

Për këto arsye, Autoriteti Kontraktues duke vepruar në përputhje me nenin 61 paragrafi 1 dhe 2 lidhur me nein 41.4 të RRPPP Nr.001/2022¹ që përcaktojnë se ndalohet përjashtimi automatik i ofertave jo-normalisht të ulëta pa përdorur një procedurë “*inter partes*”, me datën 26.06.2023 përmes Letrës Standarde ka kërkuar nga ju si OE që deri me datë 29.06.2023 të sqaroni dhe shpjegoni çmimet e ofertës tuaj që duken jo-normalisht të ulët përmes një deklaratë që përfshin një zbërthim të detajuar të pjesëve përbërse të ofertës tuaj. Konkretisht për të sqaruar apo shpjeguar çmimet e ofruara si jo-normalisht të ulëta për elementet e tenderit si në vijim: pozicioni nr. 1 (1.6, 1.8, 1.13); pozicioni nr. 2 (2.1, 2.2, 2.3); pozicioni nr. 3 (3.7); pozicioni nr. 4 (4.2, 4.7) si dhe pozicioni nr. 5 (5.1, 5.3, 5.4, 5.5) i paralogarisë të ofertës tuaj.

Me datën 28.06.2023 e kemi pranuar përgjigjen me sqarimet e ofruara nga ana e juaj e cila në shumicën e fakteve dhe rrethanave të shpjeguara nuk ka të bëjë fare me objektin lëndor të kërkesës sipas letrës standarde për sqarim të ofertës. Megjithatë, pas marrjes parasyshe dhe analizimit të konstatimeve të pohuara në përgjigjen e juaj në relacion me vlerësimin e tenderit të juaj, AK ka sipas vlerësimit të lirë ka ardhur në përfundim se shpjegimi i juaj nuk është i i mjaftuëshëm, bindës dhe i bazuar dhe si i tillë nuk e argumenton me asnjë fakt apo provë shpjegimin e situatës faktike për të arsyetuar bazueshmërinë e çmimeve të ofruara si jo-normalisht të ulëta në relacion me çmimet reale të tregut duke mos e prezentuar asnjë fakt bindës që e vërteton pohimin e juaj

¹ Në letrën standarde të kërkesës për sqarim të tenderit ka mbetur nga e kaluara gabimisht përshkrimi i Rregullës për Tenderët Jo-normalisht të Ulët, megjithatë përmbajtja e rregullës dhe dispozitës në fjalë është e njejtë me bazën ligjore në fuqi sepse rregullorja e njejtë është inkorporuar në nenin 41 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik.

bazë se kinse oferta e juaj është e përgjegjshme. Po ashtu nuk keni ofruar asnjë dëshmi materiale relevante të mbështetur në analizën e çmimeve të tregut për të argumentuar dhe dëshmuar ekonominë e procesit të shërbimeve të ofruara, zgjidhjen teknike bindëse si dhe çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për ju si tenderues origjinalitetin e furnizimit të produkteve, sigurimin e shërbimeve dhe , ekzekutimin e projektit të prokuruar. Për më tepër nëse çmimeve të ofertës tuaj i shtohen edhe llogaritja e shpenzimeve tjera vartëse. të detyrueshme e ligjore sikurse janë pagesat e tatimeve dhe kontributeve ndaj ATK-së, pagat për të punësuarit, furnizimi, shërbimi, montimi e të ngjashme, padiskutim vihet në përfundim se çmimet e ofertës tuaj për pozicionet e referuara në tërësi përbëjnë tender jo-normalisht të ulët. **Andaj kjo pikë ankimore është e pabazuar.**

Prandaj, bazuar në faktet dhe rrethanat e shpjeguara si më sipër si dhe në gjetjet që kanë rezultuar sipas vlerësimit të lirë e të pavarur, autoriteti kontraktues konsideron se shpjegimet e juaja nuk janë bindëse e të besueshme si dhe nuk paraqesin siguri për AK-në dhe në këtë kuptim ashtu siç kemi vlerësuar gjatë rivlerësimit, AK vjen në përfundim se tenderi i juaj përbën tender jo-normalisht të ulët dhe për këto arsye refuzohet siofertë e papërgjegjshme.

Sa i përket pretendimit se, aplikimi i poentimit dhe çmimeve për njësi i pamundëson ligjërisht AK-së t'i referohet çmimeve dhe të bëjë krahasim të ofertave duke ju referuar nenit 21.17 të RRPP, ju sqarojmë se nga ana e juaj është ngatërruar gjendja faktike dhe juridike duke mos u paraqitur në mënyrën e plotë të rrethanave faktike. E para, nuk qëndron i bazuar në asnjë fakt apo provë pohimi se aplikimi i poentimit dhe çmimeve për njësi na pamundëson t'i referohemi çmimeve, sepse sipas një interpretimi paraprak të KRPP-së dhe konkretisht në kuptim të nenit 54 të RRPP përcaktohet se: Kurdo që AK ka për qëllim të lidhë një kontratë me çmime për njësi, në hapje të ofertave lexohet çmimi total i poentuar (peshuar) i cili shërben vetëm për qëllim vlerësimit të ofertave, ndërsa kontrata lidhet me çmime për njësi, prandaj AK ka detyrim t'i ekzaminojë me kujdes të shtuar çmimet për njësi dhe në rast se dyshon se tenderuesi ka ofruar çmime jo-normalisht të ulëta në një apo më shumë artikuj/pozicione, duhet të veprojë në përputhje me nenin 61 të LPP-së dhe nenin 41 të RRPP. Në këtë kuptim, AK ka vepruar në harmoni me diskrecionin e lejuar dhe me kërkesat ligjore të dispozitave si më lart.

Sa i përket pretendimit se, AK ka bërë krahasimin e ofertave, mënyra e paraqitur nuk qëndron dhe si i tillë është mbështet në supozime dhe paragjykime, sepse oferta e OE ankues lidhur me çmimet për artikuj/pozicione si jo-normalisht të ulët është krahasuar me hulumtimin e çmimeve të tregut, kontratave paraprake sipas analizës të kostos të specifikimeve relevante teknike të mallrave, shërbimeve ose punëve për prokurim që është bërë para inicimit të aktivitetit të prokurimit ku edhe si rrjedhojë është përcaktuar vlera e parashikuar e projektit. Është në diskrecion të AK-së procesi i vlerësimit të çmimeve në përputhje me çmimet reale të tregut sepse sipas nenit 9 të LPP-së dhe nenit 13 të RRPP, para se të inicioj një aktivitet të prokurimit ka për obligim të hulumtoj tregun dhe të sigurojë dhe analizojë informatat e nevojshme për produktet apo shërbimet që i prokuron.

Sa i përket pretendimit se, OSHP ka dhjetëra vendime që ka vendosur ndryshe, ju sqarojmë se nuk është në kompetencën e AK-së t'i komentojë dhe bëjë vlerësime apo komente në vendimet e OSHP-së që ju i keni shkëputur dhe marrë si analogji e që nuk kanë të bëjnë me objektin dhe rrethanat e njejtë lëndore. Po ashtu, vendimet e OSHP-së që lidhen me shqyrtimin e rasteve tjera raste në aspektin legjislativ nuk kanë karakter analog dhe obligativ për AK tjera. Për më tepër ju sqarojmë se, OSHP nuk ka krijuar një standard konsistent dhe unik të vendimarrjes për të krijuar precedente të tilla, mirëpo vendos mbi meritën e secilit rast sipas objektit lëndor. **Andaj pretendimi në pikat e lartcekura është i pabazuar.**

Pretendimi i dytë: Sipas përshkrimit të deklaratës mbi faktet dhe argumentet e paraqitura, keni pretenduar se, AK nuk ju ka ofruar qasje sipas kërkesës së juaj në kohë reale dhe se në këtë mënyrë se kinse ju ka mohuar të drejtat themelore të garantuara me kushtetut dhe nenin 10 të LPP-së.

Përgjigja e AK në pretendimin e dytë:

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjilanit, sipas vlerësimit të pavarur të tij konstaton se, **pretendimi i OE ankues në tërësi është i pabazuar** në asnjë fakt apo provë relevante dhe bazë ligjore në relacion me pretendimet e pohuara. Kërkesa e juaj për qasje është dërguar në AK në ditë vikendi (e shtunë) me datën 22.07.2023, ndërsa ditën e parë të punës pas pushimit javor, ditën e hënë me datë 24.07.2023 ju është aprovuar kërkesa për qasje ashtu që qasja ju është lejuar me datën 25.07.2023 në ora 10.45. Që nënkupton se, qasja ju ka ofruar në kohën më të arsyeshme, pa asnjë pengesë duke u bazuar në rrethanat objektive dhe në pajtueshmëri me nenin 10 të LPP-së. **Andaj ky pretendim ankimor është i pabazuar.**

Pretendimi i tretë: Sipas përshkrimit të deklaratës mbi faktet dhe argumentet e paraqitura, keni pretenduar se, AK ka shkelur afatet ligjore të përcaktuara me nenin 40 të Rregullorës për Prokurim Publik Nr. 001/2022 lidhur me procedurën e vlerësimit. Më tutje keni pohuar se kinse neglizhenca dhe vonesa është shkaktuar me qëllime të caktuara ndaj ofertave të caktuara duke aluduar në pohimin e lidhjes së kontratës me ofertë me çmime më të larta. Dhe në pjesën e pretendimit të fundit keni ngritur pretendime që lidhen me ofertën e juaj si jo-normalisht të ulët duke marrë si referencë dy vendime të caktuara të OSHP-së.

Përgjigja e AK në pretendimin e tretë:

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjilanit, sipas vlerësimit të pavarur të tij konstaton se, **pretendimi i OE ankues në tërësi është i pabazuar** në asnjë fakt apo provë relevante dhe bazë ligjore në relacion me pretendimet e pohuara.

Sa i përket pohimit lidhur me shkeljen e afateve të vlerësimit, ju sqarojmë se, së pari sipas legjislacionit në fuqi të prokurimit nuk ka ndonjë afat të përcaktuar sa i përket procesit të rivlerësimit, dispozita e nenit 40 të RRPP që i referoheni është keqinterpretuar sepse kjo dispozitë përcakton afatet e vlerësimit pas procesit të hapjes së ofertave. Së dyti, duke e marrë parasysh si të mirëqenë pohimin e juaj, ju sqarojmë se vonesa eventuale ka ndodh për shkaqe objektive dhe të jashtëzakonshme të cilat nuk i atribuohen përgjegjesisë së Zyrës së Prokurimit, sepse për një periudhë të caktuar AK nuk ka pasur zyrtar përgjegjës të prokurimit. Prandaj pohimet tjera në tërësi janë në supozime dhe paragjykime të karakterit subjektiv si përpjekje për të ndryshuar rezultatin e procesit për t'i krijuar vetes favore, rrjedhimisht për të fituar një të drejtë në kundërshtim me bazën ligjore dhe nënligjore të prokurimit në fuqi.

Sa i përket pohimit lidhur me çmimet jo-normalisht të ulëta dhe vendimeve të shkëputura të OSHP-së si referencë (vendimet 757/22 dhe 671/22), ju kemi dhënë përgjigje dhe sqarime të mbështetura në fakte, prova relevante dhe rrethanat konkrete si më sipër, konkretisht në përgjigjen me nr. 2 në kontekstin e pretendimeve ankimore. **Andaj ky pretendim ankimor është i pabazuar.**

Përgjigja e AK në pretendimin e katërt:

Sa i përket pohimit se, AK e ka shkelur ligjin dhe Kodin e Etikës Profesionale se kinse kemi favorizuar kompani të caktuara që kanë pozicione me çmime të ngjashme apo identike duke mos

ju kërkuar sqarime, ju sqarojmë se pohimet e juaja në tërësi janë supozime dhe paragjykime të karakterit subjektiv si përpjekje për të prolonguar tenderin dhe tentativë për t'i krijuar vetes favore në kundërshtim me rrethanat faktike dhe bazën ligjore në fuqi me qëllim të kufizoni konkurrencën në relacion me ofertimet e OE tjerë të cilët janë në formë të përgjegjshme.

Sa i përket pohimit se, nuk kemi kërkuar sqarime nga OE tjerë, së pari konsiderojmë se kjo çështje është jashtë kompetencave të juaja, dhe së dyti pohimi i juaj nuk qënron sepse AK sipas diskrecionit të kompetencave që i ka dhe vlerësimit të lirë dhe objektiv përveq juve ka kërkuar sqarime edhe tek tre operatorë tjerë ekonomik. Ndërsa sa i përket pohimeve tjera, është e drejtë e juaja t'i shfrytëzoni të gjitha mjetet juridike në dispozicion.

Nga ana jonë garantojmë se, vlerësimin e tenderëve dhe të gjitha veprimeve tjera procedurale në relacion me të gjithë OE që kanë marrë pjesë në këtë aktivitet e ka bërë duke vepruar mbi bazën e parimeve bazike dhe themelore të prokurimit si dhe në harmoni me dispozitat përkatëse të legjislacionit të prokurimit të përcaktuara me LPP, konkretisht me nenin 1, 6 dhe 7 të LPP. **Andaj ky pretendim ankimor është i pabazuar.**

- Përfundim -

Autoriteti Kontraktues pas shqyrtimit meritor të gjitha pretendimeve të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim të LINDI MARKINGS Sh.p.k., dhe duke u bazuar në analizën e të gjitha fakteve dhe shkresat e kësaj lënde, sipas vlerësimit të pavarur dhe objektiv konstaton se pretendimet e evidentuara në kërkesën e juaj janë të pabazuara në tërësi dhe në këtë mënyrë kërkesa e juaj refuzohet në të gjitha pikat si e pabazuar.

Në këtë mënyrë, AK vlerëson se procesi i rivlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve është zhvilluar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe zbatimit në mënyrë të drejtë të nenit 59.4, nenit 60 paragrafi 1.1 lidhur me nenin 61 (nenin 41 të RRPP)si dhe me nenin 1, 6 dhe 7 të LPP-së.

Duke u bazuar në arsyet e dhëna më lart, Autoriteti Kontraktues në kuptim të nenit 108/A në paragrafin 10.1 të LPP-së dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1.1 pika (a) të lidhur me nenin 62.1 pika (d) të Rregullorës Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.


Kërtim Bajrami
Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit

Kopje:

- Operatorit Ekonomik;
- Zyrës së Kryetarit të Komunës;
- Te gjitha palëve të interesuara;

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqesë ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit të këtij vendimi.